



Sadri Ramabaja

54 Followers

About

Follow



Ibrahim Kelmendi: Kronologji historike për UÇK-në, enkas për Pressing



Sadri Ramabaja 9 hours ago · 4 min read

Në pamundësi fizike për të marrë pjesë në bashkëbisedim, po ofroj një informim telegrafik për formim dhe funksionim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Meqë nuk di të rrëfej shkurt dhe shqip, po i bie trup nga Kina.

- Edhe në mini-pernadorinë e Jugosllavisë “socialiste” përherë ka pas ide, përpjekje e angazhime çlirimtare. Ato u sforcuan sidomos në e pas Pranvesës së vitit 1981, kur Rinia studentore dhe Vegjëlia popullore që i përkrahu studentët, u rrebeluan kundër sundimit monist, diskriminues, pushtues. Në atë Pranverë u përvijua kërkesa kryesore: **Kosova-Republikë!** Kjo kërkesë bëri kthesë politike, patriotike, ideologjike, të organizatave të deriatëherëshme klandestina (të cilat gabimisht po diskualifikohen si ilegale).
- Më 17 Janar 1982 u bë bashkimi i organizatave: Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi, Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës dhe Fronti i Kuq Popullor. Me atë rast u formua **Lëvizja për Republikën e Kosovës** (në tekstin e mëtejme po e quaj vetëm Lëvizja)! Fatkeqësisht në mbrëmjen e asaj dite u vranë dy bashkëthemeluesit: Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka.
- Në vitin 1984 pati përpjekje për ta formuar “Partinë e Luftës”. Edhe në vitet pasuese pati përpjekje për të formuar forcë të armatosur çlirimtare.
- Përmbysjet e mëdha ideopolitike që ndodhen në vitet 1990/91 në Shqipëri dhe në Jugosllavi krijuan mundësi të favorshme për formim të forcave çlirimtare. Shumë pjesëtarë të Lëvizjes formonin grupe, furnizoheshin me armë në Shqipëri, me synim që të fuqizoheshin si forcë e armatosur çlirimtare. Ndërsa udhëheqja e Lëvizjes priste



korrik 1993 në Prishtinë, vendosi formimin e krahut luftarak.

- Për shkak të goditjes së rëndë që pësoi Lëvizja nga policia e shërbimet serbe pas Kuvendit të 4-tërt, Lëvizja në Emigracion, duke u bazuar në obligim statutar, u përcaktua për realizimin e atij vendimi. Për këtë qëllim Këshilli i Përgjithshëm (KP), në mbledhjen e 11 dhjetorit 1993 vendosi formimin e Fondit “Vendlindja thërret” dhe Sektorin për Rëndësi të Vëçantë (SRV). Për hir të konspiracionit, e kemi quajtur SRV ekipin që duhej të ndihmonte grupet guerile në Kosovë që të bashkohen në ushtri të përbashkët. Po për hir të konspiracionit, KP ngarkoi Kryesinë t’i caktonte anëtarët e SRV dhe ta ndihmonte e mbikëqyrte atë ekip.

- Më 17 Nëntor 1994 Kryesia ka gjykuar se tashmë grupet guerile suksesshëm po bashkërendonin sulmet guerile, prandaj ka vendos për emërimin e saj: Ushtria Çlirimtare e Kosovës! Në të njëjtën mbledhje është miratuar edhe formimi i Shtabit Qëndror. KP rëndom heshtte kur Kryesia merrte vendime të mira, edhe pse i kalonte kompetencat statutore.

- Fatkeqësisht ka rezultuar se anëtarët e SRV, Xhavit Haliti dhe Azem Sylja, kanë sabotuar e komplotuar rritjen dhe forcimin e UÇK-së, sidomos duke mos ua përcjell ndihmat financiare që i grumbullonte Lëvizja dhe simpatizantët e saj në Fondin “Vendlindja thërret”. Më të diskriminuarit kanë qenë grupet guerile në Drenicë, që komandohej nga Adem Jashari, në Llap e Gollak, që komandohej nga Zahir Pajaziti, në Dukagjin që komandohej nga Adrian Krasniqi, Luan Haradinaj, etj. Në shërbim të Xhavitit e Azemit sabotues e komplotues ishin sidomos Nait Hasani dhe Rexhep Selimi.

- Vrasjet dhe burgosjet në janar 1987 zhbënë edhe atë, i thënë Shtab Qëndror. Prandaj Epopeja në Prekaz UÇK-në e gjeti të pa përgatitur për t’iu përgjigj zhvillimeve të reja.

- Kryesia e Lëvizjes gjatë marsit dhe fillimit të prillit 1998 improvizoi një shtab (me seli në pallatin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë), për ta koordinuar kryengritjen çlirimtare që po shpërthente, e frymëzuar nga Epopja e Jasharëve. Por edhe atë improvizim e komploti Xhavit Haliti, duke e shpërdor sidomos kryeministrin kuisling Fatos Nano. Ai komplot na detyroi të mbanim Kuvendin 6-shtë, më 1 e 2 maj 1998, i cili, fatmirësisht, nuk i zgjodhi në Kryesi asnjërin nga ata, që më vonë do të quhen me zhargon pezhorativ “shtabi i Rognerit” (sipas emrit që mban hoteli austriak në Tiranë).

- Shërbimet armiqësore koordinuan të ashtuquajturin “shtab të Rognerit”, bërthama e të cilit ishin: Xhavit Haliti, Azem Sylja dhe Hashim Thaçi. Ai shtab u angazhua për ta



- Fatmirësisht UÇK-ja, e ndihmuar edhe nga luftëtarët dhe ushtarakët e dëshmuar në luftërat çlirimtare në Slloveni, Kroaci e Bosnjë, ia doli deri në qershor 1998 të formonte komandën e përbashkët në Kosovë dhe t'i shtrinte radhët në pjesën më të madhe të Kosovës.
- Për ta komplotuar atë shtab, “shtabi i rognerit” u angazhua ta kap edhe atë komandl, që tashmë ta komploton UÇK-në nga lartë. Prandaj më 12 qershor 1998 zëdhënsi i shpërdoruar, Jakup Krasniqi, bëri publike njoftimin për formim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.
- Fatmirësisht “shtabi i rognerit” nuk ia doli ta kap UÇK-në, meqë shumica e SHP, që ishte pjesë operative dhe përhershme në Kosovë, nuk pranonte komandimin nga “shtabi i rognerit”. Akoma më refuzues ndaj “shtabit të rognerit” ishin shtabet e zonave operative.
- Fakeqësisht shërbimet armiqësore, për ta komplotuar UÇK-në, të cilën atëherë e diskualifikonin si terroriste, afirmuan Hashim Thaçin si “udhëheqës” e “përfaqësues politik”. Fatmirësisht as afirmimi i Hashim Thaçit si “përfaqësues politik” nuk ia doli ta komplotonte Luftën çlirimtare.
- Fatmirësisht në fillim të tetorit 1998 rastisi që Koloneli Halil Bicaj të caktohet nga “kryeministri” Bujar Bukoshi komandant i Shtabit të FARK-ut dhe “ministër” i mbrojtjes, në vend të kolonelit Ahmet Krasniqi, tashmë të ndier. Kjo rastësi fatlume bëri që FARK të bëhet pjesë aktive e UÇK-së dhe e Luftës së përbashkët çlirimtare!
- Fatmirësisht Konferenca komplotiste në Rambuje dështoi; ajo ishte përcaktuar t'ia dorëzonte Kosovën e nënshtruar Serbisë. Dështimi i saj ndodhi për shkak të fudullëkun delirant nacionalist të Millosheviqit, i cili refuzoi ta firmoste “marrëveshjen e Rambujesë”.
- Famirësisht më 24 mars 1999 pasuan bombardimet nga NATO, duke ia imponuar kapitullimin ushtarak Serbisë, me marrëveshjen ushtarake në Kumanovë më 9 qershor 1999. Dëbimi i ushtrisë dhe policisë serbe ishte çlirimi faktik i Kosovës nga pushtimi i Serbisë.

FALËNDERIME të përjetshme UÇK-së dhe Alenacës NATO për çlirimin e Kosovës!

Paraprakisht, shpreh mirëkuptim edhe për keqkuptimin e ndonjërit në studio.

Get started

Open in app



Uçk

Lpk

Ibrahim Kelmendi

Historia

About Write Help Legal

Get the Medium app

